



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Adresa: Bashkia Himare Spile-Himare. Tel: 0393-2355. Fax: 0393-2355. E-mail: bashkiahimare@yahoo.com
Nr Prot 720 Himare : 15/03/2017

Lenda: Kerkese per leshimin e Aktit te Perputhshmerise per draftin e Planit te Pergjithshem Vendor te bashkise Himare.

Drejtuar : Znj.ADELINA GRECA
Drejtoare e pergjithshme
Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit

TIRANE

E nderuar Znj. Greca,

Duke shprehur konsideraten tone per Impenjimet Tuaja te deritanishme si dhe bashkepunimit te sukseshem te dy institucioneve dhe:

Mbeshtetur ne ligjin 107/2014 date 1.10.2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar me ligjin nr.73/2015 date 9.7.2015 dhe VKM nr.671 date 29.07.2015, nismes se Kryetarit te bashkise me Vendim nr.10 date 02.11.2015 dhe Vendimit te Keshillit Bashkiak nr.9 me date 10.08.2015, marreveshjes se bashkepunimit ndermjet Ministrise se Zhvillimit Urban dhe Bashkise Himare dhe konsulentit :Dea studio, Thymio Papayannis associates sa, per "Hartimin e Planeve te Pergjithshme Vendore per bashkite: Vlore, Himare, Sarande, Konispol" me nr.prot.2024/2 me date 13.04.2016,si dhe ne kuadrin ligjor mjedisor perkates;

Ju njoftojme se Bashkia Himare ka perfunduar procesin e hartimit te Planit te Pergjithshem Vendor per territorin e Bashkise Himare (Bashkia e vjeter Himare, njesia administrative Hor-Vranisht dhe njesia administrative Lukove).

Nga dita e sotme date 15.03.2017, eshte publikuar ne regjistrin elektronik te integruar te territorit (R.I.T) i gjithe dokumentacioni i percaktuar ne kuader te procedures perfundimtare te Planit te Pergjithshem Vendor per Bashkine tone. Ky dokumentacion eshte pergatitur me profesionalizem nga konsurciumi i firmave Dea/TPA ne bashkepunim me Drejtorine e Plnaifikimit dhe Zhvillimit te Territorit te Bashkise Himare duke patur parasysh te gjithe kriteret e nevojshme per te realizuar

kete Plan te Pergjithshem Vendor i cili do te jete nje udhezues me rendesi per territorin e mbuluar.

Per sa me siper duke u bazuar tek ligjshmeria ne fuqi, kerkojme nga autoriteti Juaj te hartoni shkresen qe permban Aktin e Perputhshmerise se draftit te Planit te Pergjithshem Vendor, ne menyre te tille qe bashkia Himare pas marrjes se ketij Akti te percaktoje sipas procedures daten per shqyrtimin dhe miratimin e ketij Plani ne Keshillin Bashkiak.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin dhe koordinimin me korrektesi ne hartimin e ketij Plani, mbetemi ne pritje te pergjigjes Tuaj.

Me respekt,



Jorgo Goro
KRYETAR

